



dt. 18/11/2014
Prot: 384

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 1170/1 Prot

Tiranë, më 11/11/ 2014

Drejtuar:

Z. Gazmend BEJTJA ✓
Drejtore i Kujdesit Shendetesor
Ministri e Shendetesise

Znj. Vjollca MECAJ
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigadave e VIII. P. TeknoProjekt
Ap. 10, Kati 5.
Tirane

LËNDA: Përgjigje lidhur me ndotjen e mjedisit nga nxjerrja e naftes dhe impakti ne shendetin e popullates ne Zharres dhe Marinze (Qarku Fier).

Bazuar ne shkresen Nr., prot 5858/1 date 16/10/2014 mbi "Ndotjen mjedisore dhe impakti ne shendet ne zonat naftembajtese dhe nxjerrese Zharrez dhe Marinze, Qarku Fier, po Ju dergojme raportin e monitorimit me rezultatet e perftuara.

DREJTORI
Dr. Arjan BREGU

Bazuar në ankesën e paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit i cili ka kryer nje inspektim lidhur me shqetesimin e popullates se zonave Zharres dhe Marinzes ne Qarkun Fier kryesisht per problemet shendetesore te cilet derivojne nga ndotja mjedisore ne keto zona (kompanite qe kryejne aktivitetet e nxjerrjes dhe perpunimit te naftes), nga ana e specialisteve te Institutit te Shendetit Publik u ndermor nje hetim specifik per shqetesimin e ngritur.

Lidhur me nivelet e ndotesve te emetuara ne ajer nga proceset e punes se kompanive qe operojne Instituti i Shëndetit Publik ju bën me dije se nuk ka kapacitete e nevojshme materiale e laboratorike për të monitoruar të gjithë ndotësit e mundshëm me prejardhje nga aktiviteti i kompanive të naftës.

Elementet të cilët mund të monitorohen janë PM_{10} , $PM_{2,5}$ të cilët nuk janë të mjaftueshëm për të kokluaduar se prania ne vlera të larta ka si burim kompanitë e naftës, kjo dhe per vete faktin se stacioni i monitorimit te ketyre treguesve eshte i vendosur prane DSHP – Fier rezultatet e te cilit nuk kane signifkancen per zonen e Zharrezes dhe Marinzes.

Ndotës të tjerë të cilët përcaktojnë më mirë ndotjen nga burime të naftës janë:

SO_2 , NO_x , CO, VOC, Benzeni, naphthalene, 1,3-butadiene, PAH (hidrokarburet aromatike policiklike), Fluor hidrogjeni, merkur dhe H_2S . Ndotësit e sipër përmendur nuk mund të monitorohen për momentin nga institucioni jonë për mungesë aparaturash prej me shume se tre vjetesh. Nga ana e institucionit mund te analizohen mostra uji dhe toke per pranine e vajit dhe grasos ne to.

Nje mungese e tille dhe mos pasja e te dhenave mbi nivelet e ndotjes nuk na lejon te themi qe ndotja ka ndikuar ne rritjen e niveleve te semundshmerise ne keto zona.


Lidhur me problematiken e semundshmerise ne popullaten e ketyre zonave u mor informacioni i duhur mbi te dhenat e semundjeve si: astme bronkiale, bronkit kronik, emphizeme pulmonare dhe Ca. pulmoni per tre vitet e fundit, te dhena ne total, te shperndare ne grup-mosha dhe ne gjini.

Rezultatet e perftuara jane prezantuar ne tabela dhe grafiket e meposhtem sipas zones.

ZHARREZ

Ne tabelen dhe grafikun 1 eshte prezantuar frekuenca e hasjes se kater nozologjive shendeteseore gjate tre viteve te fundit, nozologji te cilat mendohet se ndikohen nga ekspozimi ndaj gazeve.

grafiku 1. Prevalenca/1000 banore e semundjeve respiratore kronike gjate 2012 – 2014 ne zonen e Zharrezes - Fier



Nga grafiku tregohet qarte se gjate ketyre viteve frekuencen me te madhe e kane Astma Bronkiale dhe Bronkiti Kronik e shpjeguar ndryshe per keto dy nozologji ne 1000 banore kemi 5 – 7 raste, ndersa emfizema dhe Ca pulmonare eshte afersisht 1 rast ne 1000 banore.